

Ndikimi social-ekonomik i COVID-19

MASAT REAGUESE TË MBROJTJES SOCIALE

“Tidheunë”, nga Tanja Burzanovic (Mali i Zi)

RER Nr. 17 është një përmbledhje artikujsh mbi ndikimin social-ekonomik të COVID-19-ës, e cila do të botohet në tri pjesë. Pjesa e parë u prezantua më 29 prill dhe u përqendrua në ndikimin makroekonomik të COVID-19-ës. Kjo pjesë e dytë tregon sesi ndikimi makroekonomik prek njerëzit në rajon. Ajo trajton efektin social të COVID-19-ës në Ballkanin Perëndimor në gjashtë rubrika të veçanta të RRE-së mbi varfërinë dhe mirëqenien, punën, shëndetin, arsimin, ndotjen e ajrit dhe mbrojtjen sociale. Pjesa e tretë, e cila do të nxirret në fillim të qershorit, do të përqendrohet në fushat specifike të masave reaguese të politikave ekonomike— sektori fiskal, i jashtëm dhe financiar - dhe në pasojat e krizës në sektorin privat, sipas raportimit të firmave.

Kundërpërgjigjet e mbrojtjes sociale ndaj krizës së Covid-19 në Ballkanin Perëndimor¹

Pandemia e Covid-19 po prek tregjet e punës dhe mundësitë e njerëzve për punësim në mbarë Ballkanin Perëndimor, ndaj vendet po rritin mbështetjen e tyre për familjet e prekura. Kjo rubrikë përshkruan alternativat afatshkurtra dhe afatmesme për mbështetjen ekonomike të familjeve gjatë pandemisë dhe periudhës pasardhëse të rimëkëmbjes ekonomike, si dhe shqyrton masat që kanë shpallur apo zbatuar vendet e Ballkanit Perëndimor.

- *Në një periudhë afatshkurtër, të gjitha vendet kanë zgjeruar mbështetjen për familjet e varfra duke rritur ose përfitimet ose numrin e përfituesve të programeve të synuara të varfërisë, ose duke zbatuar programe universale të transferimit të parasë. Po kështu, vendet po nxitin mbështetjen për të papunët dhe programet që ndihmojnë firmat t'i mbajnë punonjësit në punë (d.m.th. subvencione për pagat).*
- *Në periudhën afatmesme, do të jetë me rëndësi që të vazhdohet mbështetja për programet kundër varfërisë dhe t'u ofrohet përkrahje të papunëve. Gjithashtu, duhen zgjeruar Programet Aktive të Tregut të Punës, pasi kërkesa për punë do të ketë zhvendosje midis sektorëve dhe shumë punonjësve do t'u duhet të rriten dhe të mbështeten për të gjetur punësim të ri.*
- *Është e qartë që duhen bërë kompromise financiare midis programeve dhe në kohë dhe duhen caktuar përparësi për shpenzimet. Do të jetë me rëndësi të përmirësohet veprimi i përqendruar, ndërkohë që garantohet financimi afatgjatë i mbrojtjes sociale, si dhe të kufizohet kohëzgjatja e programeve të subvencionimit të pagave, që janë të kushtueshme.*
- *Në periudhën afatmesme mund të lindë nevoja të rishikohen edhe nivelet e përfitimit të pagës së papunësisë, ndihmës sociale dhe pensioneve, sidomos, për pagesat e përkohshme shtesë, që shoqërojnë masat e reagimit ndaj krizës. Në të njëjtën kohë, programet aktive të punësimit dhe tregut të punës që kanë treguar se janë efikase duhen zgjeruar, kurse ato joefikase duhen mbyllur.*
- *Faza e rimëkëmbjes afatmesme paraqet po ashtu një mundësi për të forcuar sistemet e mbrojtjes sociale, që të bëhen më të qëndrueshme dhe të rritin aftësinë e tyre për t'iu përgjigjur krizave të ardhshme me kosto efikase.*

¹ Ky raport është përgatitur nga Alicia Marguerie, Karla McEvoy, Gonzalo Reyes dhe Jamele Rigolini. Rubrika pati kontribut me komente nga Stefanie Brodmann, Sanja Madzarevic, Cem Mete dhe Fadia Saadah, Marc Schiffbauer, Edith Kikoni, Enrique Blanco Armas, Jasmin Chakeri dhe Gallina Vincelette.

Një kuadër i thjeshtë mbështetjeje në emergjencë

Alternativat për masat reaguese të mbrojtjes sociale ndaj krizës së Covid-19 mund të klasifikohen në reagime emergjence gjatë pandemisë dhe reagime më afatgjata në mbështetje të familjeve, për të përballuar një krizë ekonomike që, me shumë gjasë, do të zgjatë më tepër.

Error! Reference source not found. përmbledh alternativat e masave reaguese. Në periudhën afatshkurtër, duhen shmangur pushimet e panevojshme nga puna, që shkaktohen nga efektet e pandemisë në ekonomi. Firmat janë prekur nga prishja e zinxhirëve të furnizimit, kufizimet e veprimtarisë (mbyllje ose orar i kufizuar) dhe ulja e kërkesës, ndaj, si punonjësit me pagesë, ashtu edhe të vetëpunësuarit, mund të humbasin punën ose aktivitetin e tyre. Duke pasur parasysh natyrën kalimtare të goditjes nga COVID-19, mbajtja e punonjësve në punë do t'ua bëjë më të lehtë firmave të rimëkëmben nga kriza ekonomike pasuese, siç dëshmoi edhe kriza e mëparshme e vitit 2008.²

Megjithatë, pushimet nga puna do të jenë të pashmangshme, sidomos në sektorët e rëndësishëm që janë prekur nga kjo goditje, si turizmi, tregtia ose transporti. Përpos largimeve nga puna, ka mundësi që të bëhet një korigjim i pritshëm i pagave duke i shkurtuar dhe ulje të orëve të punës. Për rrjedhojë, është e nevojshme që të ofrohet mbështetje emergjente për familjet, për të përkrahur si familjet formale, ashtu edhe ato joformale të prekura nga goditja, përmes masave të zgjeruara të ndihmës sociale dhe sigurimeve shoqërore.³ Këto masa mund të ndryshojnë nga ato të mbështetjes përpara krizës, duke pasur parasysh numrin masiv të njerëzve të prekur dhe nevojën për të regjistruar e mbështetur me shpejtësi familjet.

Kufizimet e aktivitetit ekonomik si reagim ndaj pandemisë - së paku në formën e tyre më dramatike – duhet të jenë të kufizuara në kohë, për shkak të kostove të konsiderueshme financiare që kanë. Sidoqoftë, edhe pas lehtësimit të tyre, rënia ekonomike mund të vazhdojë për disa kohë. Karakteristikat specifike të tregut të punës në Ballkanin Perëndimor mund të kenë po ashtu pasoja veçanërisht të forta për disa familje. Për shembull, ndalimi i udhëtimeve ndërkombëtare mund të prekë migrantët sezonalë dhe të përkohshëm, që po gjenin mundësi punësimi në vendet që tashmë kanë mbyllur kufijtë. Edhe dërgesat në para, një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje në Ballkanin Perëndimor, mund të pësojnë rënie. Derisa ekonomia të jetë rimëkëmbur, do të duhet që familjet që kanë rënë në varfëri ose thuajse në varfëri, si dhe të papunët, të mbështeten përmes fondeve të zgjeruara të kursimit/ rrjetet e mbrojtjes sociale dhe sigurimeve shoqërore dhe të marrin ndihmë për gjetjen e punëve të reja përmes masave të nxitjes së punësimit. Pavarësisht kësaj, efektet fiskale do të jenë të konsiderueshme dhe qeverive do t'u duhet të gjejnë ekuilibrin midis masave që mbështetin rritjen dhe investimet dhe përkrahjes së familjeve në kuadrin e një sjelljeje fiskale të qëndrueshme.

Në të gjitha fazat, mbështetja duhet t'u përshtatet profileve të njerëzve. Mbështetja që mund t'u ofrohet, për shembull, punonjësve në sektorin formal mund të jetë ndryshe nga mbështetja që mund t'u jepet punonjësve informalë ose atyre thuajse të varfër. Që mbështetja të jete efektive, secili grup mund të

² Shih edhe raportin shoqëruar RRE: "Tregjet e punës në Ballkanin Perëndimor gjatë tronditjes nga COVID-19-a" për një diskutim më të hollësishëm rreth punësimit të mundshëm dhe ndikimit mbi pagat.

³ Shih po ashtu raportin shoqëruar RRE: "Efektet e COVID-19 mbi varfërinë dhe mirëqenien familjare në Ballkanin Perëndimor" për një shtjellim më të hollësishëm të efektit të mundshëm të krizës mbi varfërinë dhe shpërndarjen e të ardhurave.

kërkojë masa reaguese politike të dedikuara dhe, duke pasur parasysh shkallën masive të sfidës, mund të lindë nevoja për të vendosur përparësi.

Masat reaguese afatshkurtra ndaj krizës së Covid-19

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë miratuar një gamë të gjerë masash reaguese në kuadër të politikave të mbrojtjes sociale, që synojnë të mbështetin punonjësit e sektorit formal, të papunët, të varfrit dhe të moshuarit, të cilat do t'i shqyrtojmë më poshtë. Disa prej këtyre masave (si subvencioni i pagave) mund të jenë instrumente të vlefshme politikash për një periudhë afatshkurtër, por mbeten mjaft të kushtueshme dhe mund të jenë më pak efektive si masa reaguese afatgjata. Për rrjedhojë, do të jetë me rëndësi që ky kombinim politikash të ndryshojë e të përshtatet përgjatë fazave të reagimit.

Mbështetja afatshkurtër e firmave në sektorin formal për shmangien e pushimeve nga puna

Për një periudhë afatshkurtër, mund të ndërmerren masa për mbajtjen në punë të punonjësve nga firmat e sektorit formal, si reagim ndaj goditjes së përkohshme të furnizimit. Mbajtja e punonjësve në punë kufizon numrin e të papunëve, numrin e familjeve që kanë nevojë për ndihmë sociale shtesë dhe, çka është më e rëndësishme, ruan marrëdhënien e punës midis firmave dhe forcës së punës, që është kyçe për t'u përgatitur për rinisjen e prodhimit pas krizës. Ekzistojnë disa instrumente që mbështeten në të njëjtën ide themelore: uljen e kostove të punës në kohën e ngadalësimit ekonomik, për t'u dhënë mundësi firmave të mbajnë të punësuar forcën aktuale të punës.

Subvencionet e punësimit ose pagave janë transfertat (të drejtpërdrejta) për punëdhënësit, që kanë për qëllim të mbulojnë plotësisht ose pjesërisht pagat e forcës së punës. Punonjësit mbahen në punë me një kosto më të ulët për firmat, pavarësisht orëve të shkurtuara ose asnjë ore pune. Kualifikimi për subvencionet e pagave mund të bazohet në kushtin që firmat duhet të mbajnë një përqindje të caktuar të forcës së tyre të punës. Subvencionet e pagave kanë rezultuar efektive për parandalimin e shkatërrimit të punësimit gjatë krizave të mëparshme në shkallë të gjerë. Megjithatë, ato duhet të jenë në vlerë të mjaftueshme për të stimuluar mbajtjen në punë të punonjësve dhe mund t'i kushtojnë shumë qeverisë. Në ekonomitë kryesore të OECD-së, subvencionet e pagave për punonjësit e larguar përkohësisht janë caktuar deri në 90% në Danimarkë dhe 80% në Mbretërinë e Bashkuar. Të tilla nivele janë të vështira për t'u financuar në shumicën e vendeve me të ardhura të mesme të larta dhe të ardhura të mesme të ulëta. Në Maqedoninë e Veriut, për shembull, është vlerësuar se një subvencion gjithëpërfshirës i pagave për 250 000 punonjës në vlerën e pagës minimale mund të kushtojë më shumë se 60 milionë euro në muaj. Sa u takon firmave, mbulimi i pjesës së mbetur të pagave të punonjësve - nëse lind si nevojë nga masat e reagimit ndaj krizës ose nga legjislacioni i punës në fuqi në vend— mund të jetë sërish i vështirë, kur përballen me kufizime likuiditeti dhe, për pasojë, të mos jete efektiv për parandalimin e pushimeve nga puna. Një ndryshim i mundshëm i kuadrit ligjor mund t'i ndihmojë më tej firmat, duke i lejuar të paguajnë pjesë të pagës së pambuluar vetëm deri në një prag të caktuar (çka do të thotë ulje e përkohshme e pagave).

Ka disa alternativa për të përmirësuar koston efektive të subvencionit të pagave. Një prej tyre është kompensimi (i pjesshëm) i punonjësve për orët e shkurtuara, ndërkohë që firma vazhdon t'i paguajë (pjesërisht ose plotësisht për kohën e mbetur efektive të punës. E njohur si “skemat e përkohshme të punës me kohë të shkurtuar”, kjo alternativë zbatohet, mes të tjerash, në Gjermani, Francë dhe Itali, por kërkon një sistem që lejon përqendrimin vetëm tek ata punonjës që punojnë me kohë të shkurtuar apo që janë larguar përkohësisht nga puna. Një tjetër mundësi është përqendrimi te firmat specifike sipas sektorëve (turizmi, hoteleria) ose madhësisë: ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme ka më shumë gjasë të kenë nevojë për mbështetje, për shkak të kufizimeve që hasin në likuiditet.

Njoftimi dhe zbatimi në kohë i subvencioneve të pagave janë kyçe për të shmangur pushimet masive nga puna, duke qenë se trysnia e likuiditetit mbi firmat mund të sjellë largime nga puna që në momentet e para të krizës. Po ashtu, është me rëndësi që subvencionet e pagave të jenë të kufizuara në kohë: ato janë efektive vetëm si masa të përkohshme, për t'i ndihmuar firmat të rikthehen pas goditjes dhe nuk janë në asnjë mënyrë zëvendësuese efektive afatgjata për pagesën e papunësisë dhe ndihmën sociale, që janë me kosto shumë më efektive duke pasur parasysh natyrën e përqendruar që kanë. Së fundi, ato duhet të mendohen si përplotësuese të masave të tjera mbështetëse për likuiditetin e firmave, si huatë e subvencionuara apo grantet kapitale, të cilat kanë si kusht me mbajtjen në punë të punonjësve.

Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë njoftuar subvencionimin e pagave për të mbështetur punësimin. Në Serbi, qeveria deklaroi se do të mbulonte pagat e tre muajve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Në ndërmarrjet e mëdha, të gjithë punonjësve kontrata e të cilëve ka përfunduar për shkak të krizës do t'u paguhet 50 për qind e pagës minimale. Në Kosovë, pagat mujore do të mbulohen për muajt prill dhe maj me një vlerë të barabartë me pagën minimale, një masë e cila llogaritet në 41 milionë euro. Në Maqedoninë e Veriut, është deklaruar se do të subvencionohen pagat (sërisht, në vlerën e pagës minimale) për 9 000 punonjës artizanalë dhe rreth 250 000 punonjës të firmave të sektorit privat, që regjistrojnë të paktën 30% rënie në të ardhura për shkak të krizës. Në Malin e Zi, është njoftuar subvencionimi i pagës për dy muaj deri në vlerën 100% të pagës minimale për të gjitha firmat në sektorët e prekur, si dhe një subvencionim gjashtëmujor i pagës për punësimin e deklaruar rishtas në të gjithë sektorët, për të nxitur formalizimin e punësimin.

Ulja e kostove të tjera që lidhen me listëpagesat (zakonisht, kontributet e sigurimeve shoqërore ose pensione) përbën një tjetër mënyrë të subvencionimit të pagave. Ato paguhen nga punëdhënësi mbi pagën neto dhe pagesat e diferencuara të këtyre tatimeve ose lehtësimet mund të ulin përkohësisht kostot e punës. Këto masa mund të kushtëzohen me mbajtjen e të gjithë forcës së punës ose një përqindjeje të saj nga firmat për një periudhë të caktuar. Ka të ngjarë që zbatimi të jetë më i shpejtë, pasi mbështetet në një sistem e regjistër ekzistues. Megjithatë, ai mund të krijojë çrregullime në funksionimin e agjencive të tjera që kanë lidhje me pensionet dhe sigurimet shoqërore. Nga pikëpamja e buxhetit, preferohet shtyrja në vend të përjashtimit apo uljes. Në të kundërt, qeveria duhet të caktojë nga buxheti i përgjithshëm burime shtesë për të mbuluar kontributet e fshira dhe për të ruajtur një qëndrueshmëri afatgjatë të fondeve të sigurimeve shoqërore dhe pensione. Në ngjashmëri me subvencionet e drejtpërdrejta të pagave, një ulje e vogël e kostove të përgjithshëm të punës mund të mos jetë e mjaftueshme për t'i mbajtur punonjësit, por kjo masë mund të shoqërohet me subvencionet e

drejtpërdrejta të pagave ose me masa të tjera, që u vijnë në ndihmë firmave për të përballuar kufizimet e likuiditetit.

Bosnje-Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi po ecin përpara me shtyrjen ose fshirjen e kostove të tjera që lidhen me pagat. Kosova deklaroi mbulimin e kontributeve të pensionit për prillin dhe majin, me një vlerë prej 8 milionë eurosh. Në Malin e Zi, firmat mund t'i shtyjnë pagesat e tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore; në sektorët më të prekur, firmat janë plotësisht të përjashtuara prej tyre për dy muaj. Në Bosnje-Hercegovinë, të dyja entitetet po subvencionojnë ose mbulojnë kontributet, edhe pse në forma të ndryshme (shih Shtojcën).

Masat e sigurimeve shoqërore në përgjigje të krizës

Masat më të zakonshme lidhur me sigurimet shoqërore që janë miratuar deri tani mbulojnë pagesën e papunësisë dhe pensionet.

Pagesa e papunësisë. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Kosovës, kanë një skemë për pagesën e papunësisë (PP). Kriza e Covid-19 pritet të rritë në mënyrë të konsiderueshme papunësinë në të gjitha vendet dhe pasja e këtyre sistemeve përbën një avantazh mjaft të mirë reagues. Megjithatë, kriza do të kërkojë disa ndryshime në konceptim. Sistemet mund të duhet të japin përkohësisht përfitime shtesë apo të lehtësojnë disa prej kushteve të kualifikimit, me qëllim që t'i përgjigjen rritjes të beftë të papunësisë. Po kështu, qeveritë duhet të përforcojnë kapacitetet administrative të pagesës së papunësisë dhe shërbimeve publike të punësimin, për t'iu përgjigjur rritjes së kërkesës për shërbimet e këtyre të fundit, lehtësimin të regjistrimit të statusit të papunësisë dhe përpunimit të pagesave. Ka gjasë që periodat e pritjes të hiqen e procedurat të integrohen, për të ulur kohën e pritjes.

Mbështetur në rregullat ekzistuese, vendet e Ballkanit Perëndimor do të marrin një sërë masash. Mes të tjerave, vendet mund të ulin afatin e kontributeve të kërkuara për t'u kualifikuar për marrjen e përfitimeve. Po ashtu, vendet mund të përshtatin nivelet e përfitimit për një periudhë afatshkurtër, sidomos në ato sisteme që ofrojnë një përfitim të sheshtë me vlerë relativisht të ulët (Mali i Zi, Shqipëria dhe Federata e Bosnjë-Hercegovinës) ose të marrin në konsideratë pagesën e njëherëshme të përfitimit për të plotësuar përfitimet e PP-ve. Së fundi, vendet mund të duhet edhe të shtrijnë kohëzgjatjen e përfitimeve, me gjasë, deri të paktën në 5-6 muaj, edhe për ata përfitues që mund të mos kenë kontribuar në numrin e nevojshëm të muajve që duhen për të përfituar nga paketa e plotë e përfitimit.

Disa prej këtyre masave po zbatohen ose janë shpallur. Për shembull, Shqipëria do të ofrojë përfitime të papunësie në dyfishin e vlerës dhe Mali i Zi do të ofrojë një pagesë të njëherëshme prej 50 eurosh, për të plotësuar përfitimet për të gjithë të papunët. Në Serbi, qeveria do të lejojë që aplikuesit t'ia paraqesin kërkesat për përfitime papunësie Shërbimit Kombëtar të Punësimin përmes postës ose postës elektronike. Të gjitha vendet kanë caktuar burime të tjera shtesë për të mbuluar rritjen e pritshme të marrësve të përfitimit të papunësisë.

Në periudhën afatmesme deri në afatgjatë, sidomos nëse procesi i mëkëmbjes do të kërkojë kohë, do të jetë po ashtu me rëndësi të shihen efektet fiskale të financimit të një rritjeje afatgjatë në përfitimet e papunësisë dhe të vlerësohen kundrejt masave të tjera që do të merren në mbështetje të procesit të

mëkëmbjes. Rritja e mundshme e përfitimeve të papunësisë ka efekte fiskale shumë më të mëdha sesa, të themi, ndihma sociale. Përlllogaritjet paraprake tregojnë, për shembull, se, nëse norma e papunësisë Në Maqedoninë e Veriut do të dyfishohej dhe përfitimet do të zgjateshin me dy muaj të tjerë, kostoja shtesë e programeve do të ishte më shumë se 70 milionë euro në vit. Në varësi të kohës së nevojshme për procesin e rimëkëmbjes, mund të jetë nevoja të shqyrtohen ndryshime në konceptimin e programit, për t'u siguruar që qeveria do të jetë e aftë të përballojë përfitimet e papunësisë siç janë të konceptuara aktualisht.

Pensionet. Edhe pse të moshuarit janë grupi më i rrezikuar nga pikëpamja shëndetësore, ata duhen mbrojtur nga rënia ekonomike, nëse mbështeten te pagesa e pensionit. Sidoqoftë, skemat e pensionit duhet t'u përshtaten nevojave të distancimit social dhe rregullave të karantinës. Përfituesit mund të kenë nevojë edhe për mbështetje shtesë që të qëndrojnë në shtëpi, të kufizojnë daljet jashtë dhe të mbulojnë çdo kosto shëndetësore shtesë. Për të shmangur daljet e panevojshme e për të nxitur distancën sociale, qeveritë mund t'i mbledhin bashkë pagesat në transfertat më pak të shpeshta, sidomos kur pagesat merren personalisht në vend. Edhe kushtet për verifikimin e personit drejtpërdrejt mund të shtyhen. Një pagesë shtesë apo pagesë e njëhershme mund të merret në konsideratë për të kompensuar kostot shtesë, sidomos për përfituesit e pensioneve me vlerë të vogël. Duke pasur parasysh kompromiset masive në shpenzime me të cilat po përballen shumë vende, do të jetë me rëndësi që të vlerësohet nevoja për rritjen e pensioneve kundrejt nevojave të tjera për ndihmë sociale dhe sigurime shoqërore dhe të sigurohet zhvillimi i fushatave të përshtatshme të komunikimit për të shpjeguar se çdo rritje pensioni që lidhet me situatën e *Covid*-it do të ketë afat të kufizuar.

Një sërë vendesh të Ballkanit Perëndimor kanë njoftuar marrjen e masave për pensionistët. Në Serbi, për shembull, të gjithë pensionistët do të marrin mbështetje me një vlerë të vetme prej 4 000 dinarësh (rreth €35) dhe pensionistët mund t'i japin dikujt autorizim të posaçëm për të tërhequr pagesat për llogari të tyre. Në Kosovë, të gjitha kërkesat për verifikim janë pezulluar dhe pensionistët që paguhën më pak se 100 euro do të marrin një shtesë të përkohshme prej 30 eurosh.

Masat reaguese të ndihmës sociale për të varfrit dhe thuajse të varfrit

Ndihma sociale ose fondet për sigurinë sociale kanë më shumë mundësi të mbështetin familjet e varfra, thuajse të varfra dhe në informalitet, që përballen me humbjen e të ardhurave për shkak të pasojave ekonomike të COVID-19-ës. Programe të tilla ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë, si në formën e parave, ashtu edhe të të mirave materiale në mallra dhe shërbime që zbutin konsumin, kompensojnë rritjen e çmimeve dhe parandalojnë rënien e mëtejshme në varfëri. Këto programe janë përdorur për t'iu përgjigjur krizave ekonomike, katastrofave natyrore dhe epidemive, siç ishte kriza e vitit 2008 e ushqimit, financave dhe karburantit dhe shpërthimi i ebolës në vitet 2014-2015. Alternativat e mundshme për përdorimin e ndihmës sociale për trajtimin e efekteve të menjëhershme dhe më afatgjata të COVID-19 janë:

Harmonizimi i procedurave të ricertifikimit. Shumica e programeve sociale kërkojnë që familjet të vërtetojnë plotësimin e kriterëve dhe një rifreskim sistematik të regjistrimit. Disa prej tyre kanë edhe afat për këtë vërtetim kualifikimi. Pandemia e ndërlikon procesin e ricertifikimit, që bëhet edhe më i panevojshëm duke pasur parasysh se numri i familjeve që ka gjasë të mos kualifikohen më është më i ulët. Afatet po ashtu duhet të lehtësohen përkohësisht, duke pasur parasysh gjasat e pakta që përfituesit të

kanë qenë në gjendje të diplomohen apo të gjejnë punësim. Një sërë vendesh të Ballkanit Perëndimor i kanë harmonizuar procedurat e ricertifikimit. Në Maqedoninë e Veriut, për shembull, rregulli tremujor për vlerësimin e të ardhurave është lehtësuar, për të marrë parasysh rënien e papritur të të ardhurave të familjeve dhe në Serbi qeveria ka shtyrë të drejtën e përfitimit të ndihmës sociale mbi bazën e vendimeve të nxjerra më parë për një periudhë maksimale tremujore.

Harmonizimi i procedurave të regjistrimit për ndihmë sociale. Kriza do t'i bëjë shumë familje thuajse të varfra të bien në varfëri, duke plotësuar kushtet për ndihmë sociale. Procedurat e regjistrimit duhen harmonizuar për të siguruar regjistrimin e duhur dhe në kohë të këtyre përfituesve në skemën e ndihmës sociale dhe mund të organizohen fushata komunikimi për t'i ndërgjegjësuar e nxitur familjet të kontrollojnë nëse kualifikohen dhe të aplikojnë – një strategji që po zbatohet aktualisht në Bosnjë-Hercegovinë.

Përfitimet plotësuese të përkohshme për përfituesit ekzistues. Ka gjithashtu një arsye për të plotësuar përfitimet e përfituesve ekzistues të ndihmës sociale, që ata të përballen me sfidat ekonomike e shëndetësore që janë shfaqur, si rritja e shpenzimeve mjekësore dhe kufizimet e çdo lloji veprimtarie ekonomike. Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor po planifikon t'i zgjerojë këto përfitime. Mes të tjerave, në Shqipëri, marrësit e ndihmës ekonomike (programi kryesor i transferimit të parave në dorë) do të marrin dyfishin e vlerës së përfitimit përkohësisht; Kosova ka në plan dhënien e një pagese shtesë prej 30 eurosh në muaj të gjithë përfituesve të ndihmës sociale dhe skemave të pensionit, që marrin një pagesë mujore nën 100 euro dhe në Malin e Zi, rreth 11 900 pensionistë të cilët marrin pensionin më të ulët dhe 8 500 përfitues të ndihmës familjare do të marrin një pagesë prej 50 eurosh që do të jepet vetëm njëherë. Disa grupe në nevojë, si të moshuarit, mund të përfitojnë gjithashtu nga shpërndarja e mallrave thelbësore. Bosnjë-Hercegovina, për shembull, deklaroi se do të shpërndajë paketa të kujdesit bazë (që përbëhen nga produkte të higjienës vetjake dhe të shtëpisë) për të moshuarit dhe njerëzit në nevojë, që kanë nevojë për kujdes të përhershëm në institucione të specializuara. Edhe pse këto pagesa shtesë mund të jenë mbështetje e madhe për nevojat në rritje të familjeve në nevojë, është gjithashtu e rëndësishme që ato të shoqërohen nga fushata të përshtatshme komunikimi ku theksohet natyra e përkohshme e këtyre përfitimeve.

Përfshirja e përkohshme e përfituesve thuajse të varfër. Programet sociale mund të duhet që të lehtësojnë edhe rregullat e kualifikimit për regjistrimin në to përkohësisht të familjeve thuajse të varfra, që, në rrethana normale, nuk do të kualifikoheshin për këto përfitime. Kjo ndodh pasi kriteret kualifikuese, si testet me përafërsi, nuk janë domosdoshmërisht në gjendje të kapin rënien në të ardhura (sidomos për punonjësit joformalë) dhe sepse shumë familje thuajse të varfra janë prekur po aq keq nga kriza sa ato të varfra. Zgjerimi i ndihmës sociale për të përfshirë përkohësisht familjet thuajse të varfra është e dëshirueshme sidomos në vendet me mbulim të ulët të sistemeve të sigurimeve shoqërore, si vendet me sektorët me informalitet të lartë apo nivele të ulëta punësimi. Shumë vende të Ballkanit Perëndimor po e marrin në konsideratë këtë zgjerim përkohësisht. Në Shqipëri, për shembull, familjet e vetëpunësuarat do të përfitojnë një pagesë të posaçme të barasvlershme me një pagë mujore shtetërore dhe Kosova planifikon t'u paguajë 130 euro qytetarëve që humbasin punën për shkak të situatës së emergjencës shëndetësore, për muajin prill, maj dhe qershor. Një çështje me rëndësi për t'u marrë në konsideratë

është komunikimi si duhet i karakterit të tyre të përkohshëm. Në kundërshtim me ndihmën e zakonshme sociale, përfituesit nuk duhet të presin që këto përfitime të vazhdojnë për një afat të pacaktuar.

Disa vende në rajon kanë zgjedhur të kryejnë një transfertë të vetme për çdo të rritur (d.m.th. Serbia, Mali i Zi). Edhe pse ka përfitime me qasje universale (për shembull, transfertat do të shtrihen te shumë punonjës informalë në nevojë, që mund të mos kualifikohen për ndihmë sociale), është me rëndësi që të tilla qasje të mos minojnë aftësinë e vendit në një periudhë afatmesme për të financuar si duhet fondet e kursimit që përdoren për varfërinë, sidomos duke pasur parasysh rritjet e konsiderueshme të niveleve të varfërisë gjatë krizës dhe mëkëmbjes që pason.

Po sektori informal?

Mbështetja e punonjësve të sektorit informalë në kohë krize është sfidë e madhe, duke qenë se, sipas përkufizimit, firmat dhe punonjësit informalë nuk janë të regjistruar tek autoritetet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore. Megjithatë, është me rëndësi që ata të mbështeten, si nga pikëpamja e barazisë (të varfrit punojnë masivisht në sektorin informal), edhe nga pikëpamja e mëkëmbjes ekonomike (firmat informale, edhe pse nuk paguajnë tatime, kontribuojnë në rritjen ekonomike, janë pjesë e zinxhirëve të vlerave dhe sigurojnë punësim për personat që, përndryshe, do të kishin nevojë për mbështetje nga shteti).

Nuk ka një shkop magjik për të mbështetur sektorin informal dhe është e pashmangshme që disa firma e punonjës informalë të mos marrin mbështetje. Sidoqoftë, ka mënyra për t'u ofruar mbështetje grupeve të rëndësishme të popullsisë në sektorin informal. Për shembull, programi i ndihmës sociale mund të shtrihet edhe te familjet thuajse të varfra që nuk marrin të ardhura formale ose forma të tjera të mbështetjes publike. Këto familje ka të ngjarë jenë prekur rëndë nga kriza dhe mbështetja e tyre është me rëndësi edhe nga pikëpamja e shëndetit publik – nëse nuk marrin mbështetje, ka të ngjarë që ato të vazhdojnë të punojnë, duke e ulur efektivitetin e masave të distancës sociale. Disa vende të Ballkanit Perëndimor, si Shqipëria dhe Kosova kanë shpallur marrjen e masave të ngjashme. Edhe pse janë me kosto të lartë fiskale, transfertat e vetme, si ato që janë njoftuar në Malin e Zi dhe Serbi, garantojnë mbulimin e sektorit informal.

Një kanal i dytë është mbështetja për firmat informale. Edhe pse shumë prej tyre nuk janë të regjistruara zyrtarisht, shumë firma informale kanë kontakte të kufizuara me sektorin formal përmes furnitorëve të këtij të fundit dhe institucioneve të mikrokredisë, për shembull. Kështu, edhe pse do të ishte e paplotë, mund të përpilohet një listë e firmave të sektorit informal të cilave mund t'u ofrohet një formë mbështetjeje.

Alternativat afatmesme: ekuilibrimi i mbështetjes për familjet me masat e mëkëmbjes

Shumica e alternativave afatshkurtra të mbrojtjes sociale për të mbështetur familjet mbeten të vlefshme për një periudhë afatmesme. Megjithatë, në një periudhë afatmesme do të ishte një sfidë për disa vende që të vendosnin një ekuilibër midis mbështetjes së familjeve dhe masave stimuluese, duke qenë se të dyja ndërhyrjet do të kërkojnë investime të konsiderueshme. Pasojat ekonomike të pandemisë shëndetësore do të zgjatën për një kohë të konsiderueshme, kështu, është e nevojshme që të caktohet përparësi mes

ndërhyrjeve si midis programeve, ashtu edhe në kohë. Edhe pse mund të jetë tunduese të përdoret e gjithë artilleria e rëndë fiskale në fillim të pandemisë, është me rëndësi që të ruhet një lloj hapësire fiskale për të mbështetur rimëkëmbjen e gjatë ekonomike. Për mbrojtjen sociale, i duhet dhënë përparësi aftësisë për të financuar një fond të zgjeruar kursimi për varfërinë, që është bastioni i fundit që parandalon familjet e varfra të bien në varfëri të skajshme. Konceptimi dhe legjislacioni i programit të sigurimeve shoqërore mund të ndryshohet gjithashtu për të ruajtur aftësinë e financimit të rritjeve të konsiderueshme të aplikimeve të papunësisë në periudhën afatmesme.⁴ Paralelisht, me heqjen e kufizimeve të punësimit, programet e punësimit që synojnë të mbështetin rikthimin në tregun e punës duhen përmirësuar e zgjeruar po ashtu.

Sigurimi i financimit të mjaftueshëm, duke përmirësuar koston efektive të programeve të mbrojtjes sociale

Është me rëndësi të sigurohet një financim i mjaftueshëm afatmesëm i programeve të mbrojtjes sociale, duke punuar, në të njëjtën kohë, për të përmirësuar koston e tyre efektive. Programet e reagimit të shpejtë, që mund të jenë të përshtatshme për një periudhë afatshkurtër (si transfertat e vetme universale në para), mund të mos jenë të qëndrueshme në periudhën afatmesme, sidomos kur merret në konsideratë nevoja për financimin e masave shtesë të rimëkëmbjes. Në periudhën afatmesme, për rrjedhojë, mund të marrë rëndësi rritja e efektivitetit të koston së masave të mbrojtjes sociale, duke rivlerësuar, për shembull, nivelet e përfitimit dhe duke përmirësuar fondet e kursimit për varfërinë, si dhe duke krijuar lidhje më të mirë midis përfituesve të ndihmës sociale dhe programeve të punësimit që mbështetin rikthimin në tregun e punës. Nivelet e përfitimit të pagesës së papunësisë dhe pensioneve mund të kenë gjithashtu nevojë të rishikohen (veçanërisht, pagesat e përkohshme shtesë që shoqërojnë përgjigjen ndaj krizës), për të siguruar aftësinë e financimit të qëndrueshëm të sistemit.

Intensifikimi i politikave të nxitjes së punësimit për të mbështetur rikthimin në tregun e punës

Kriza nuk do të shkaktojë vetëm lëvizje masive në punë dhe jashtë saj, por duke i prekur në mënyrë të ndryshme sektorët, do të çojë edhe në rishpërndarjen e punëve dhe aktiviteteve ekonomike midis sektorëve. Vendet e punës që njerëzit humbën nuk do të jenë domosdoshmërisht të njëjtat që do t'u vihen në dispozicion dhe do të jetë e nevojshme të intensifikohen programet aktive të tregut të punës (PATP) për të ritrajnuar shumë punëkërkues e për t'i ndihmuar të gjejnë punë në sektorët e rinj.

Në përgjithësi, vendet e Ballkanit Perëndimor shpenzojnë shumë pak për PATP-të dhe programet e ofruara nga shërbimet publike të punësimit nuk janë gjithnjë të përshtatura për profilet e popullatës së

⁴ Shih artikullin shoqëruar RRE: "Parashikimi për Ballkanin Perëndimor: kohë të vështira kërkojnë ekonomi të mirë" për një trajtim më të hollësishëm të kompromiseve midis zbutjes afatshkurtër të krizës dhe masave të politikave afatmesme.

cilës i shërbejnë apo nevojave të ekonomisë. Për rrjedhojë, do të jetë me rëndësi të përmirësohen e zgjerohen PATP-të, për t'i bërë të përshtatshme për nevojat e sektorëve që do të rimëkëmben. Përpjekjet për zgjerimin dhe përshtaten me nevojat aktuale mund të fillojnë herët, për shembull, përmes këshillimit dhe trajnimeve në internet, të cilat mund të zhvillohen edhe gjatë kohës kur masat e distancimit social dhe kontrollit të transmetimit janë në zbatim. Në Rumani, për shembull, qeveria autorizoi kryerjen e të gjitha veprimtarive trajnuese nëse zhvilloheshin përmes internetit dhe në Estoni, qeveria ofron këshillim dhe ndërmjetësim në internet për të kërkuar punë. Po kështu, do të jetë me rëndësi të përmirësohen partneritetet, bashkëpunimet dhe bashkërendimi me ofruesit e shërbimeve të punësimit në sektorin privat, që, për momentin, janë mjaft të kufizuara.

Kushtet fillestare kanë rëndësi: një mundësi për forcimin e sistemeve të mbrojtjes sociale

Aftësia për t'iu përgjigjur krizave me kosto efektive ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga vendi në vend dhe varet në një masë të madhe nga hapësira e tyre fillestare fiskale dhe aftësia e sistemeve për t'iu përshtatur shpejt e për t'iu zgjeruar në kohë krizash. Instrumentet e mbrojtjes sociale, si regjistrat socialë, procedurat e thjeshtuara dhe të kompjuterizuara të regjistrimit dhe verifikimit, bazat e përditësuara dhe të integruara të të dhënave të sigurimeve shoqërore dhe listëpagesave, sisteme të mirorganizuara të pagesave dhe një legjislacion që lejon përshtatjet në kohë emergjencash jo vetëm mundësojnë një ndihmë sociale të formatuar më mirë në kohë normale, por gjithashtu u japin mundësi sistemeve të zgjerohen me shpejtësi në kohë krizash me kosto efektive.

Faza e rimëkëmbjes afatmesme paraqet një mundësi për forcimin e sistemit të mbrojtjeve sociale, për t'i bërë më të qëndrueshëm e për të rritur aftësinë e tyre reaguese ndaj krizave të ardhshme me kosto efektive.

Një nga shembujt janë subvencionet e pagave. Në shumë vende të BE-së, shteti paguan vetëm për numrin aktual të punonjësve që nuk punojnë ose për shkurtimin e orëve të punës dhe ka ligje në fuqi që i lejojnë firmat dhe shtetin të ulin përkohësisht rrogat/pagesat e punonjësve që janë pushuar përkohësisht nga puna. Këto ligje dhe aftësia monitoruese, për të cilën duhet që bazat e të dhënave të sigurimeve shoqërore dhe listëpagesave të jenë të mirintegruara dhe të përditësuara, mungojnë në shumë prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, që ende do të duhet të mbështeten në subvencione të përgjithshme pagash shumë më të kushtueshme dhe më pak efektive.

Një argument i ngjashëm mund të vlejë edhe për regjistrat socialë dhe procedurat e kompjuterizuara të regjistrimit/verifikimit. Regjistrat socialë bëjnë bashkë informacionet e bazave të të dhënave nga disa ministri, për të mbajtur një informacion të përditësuar jo vetëm rreth përfituesve të programeve të ndihmës sociale, por edhe rreth popullsisë së përgjithshme. Regjistrat socialë të përpiluar si duhet mund të ndihmojnë, për rrjedhojë, me identifikimin e grupeve të popullsisë që janë prekur posaçërisht nga krizat dhe të përshpejtojnë procedurat e regjistrimit dhe verifikimit të tyre.